



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060/04-38023 dt. 10/09 2020

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 24.08.2020, ora 10:00.

Kryesuesi i mbledhjes, Labinot Halilaj i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e KPF-së: Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin edhe shefi i Kabinetit të Kryetarit, Flamur Curri, Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu.

Komiteti filloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.07.2020.
2. Raporti i punës së Kryetarit Janar –Qershor 2020.
3. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik /juridik.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj- hapi mbledhjen e KPF-së, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës.

Pasi nuk pati diskutime lidhur me rendin e ditës, Kryesuesi Halilaj hodhi në votim rëndin e ditës së bashku me një pikë shtesë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan gjashtë (6) anëtarë

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 24.08.2020. Pasi nuk pati diskutime për procesverbalin, Kryesuesi Halilaj e hedhi në votim, ku anëtarët e miratuan në mënyrë unanime.

Kryesuesi Halilaj hapi diskutimin për pikën dytë të rendit të ditës: 2. Raporti i punës së Kryetarit Janar –Qershor 2020. Meqë kjo pikë nuk votohet, anëtarëve iu prezantua raporti gjashtëmujor i punës së Kryetarit, Ramiz Lladrovci. Të njëjtit nuk patën ndonjë diskutim lidhur me raportin.


Pika e tretë “Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik /juridik”, pas diskutimeve ndërmjet anëtarëve, u votua në mënyrë unanime.

Te pika ‘të ndryshme’, nuk pati ndonjë temë apo çështje për diskutim nga ana e anëtarëve të KPPF-së. Pas këtyre pikave, kryesuesi Labinot Halilaj i shpalli të mbyllura punimet e komitetit.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 30

Drenas, 24.08.2020

Procesmbajtëse:



Fatlinda Zymeri


Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj